



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0241

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (GOE) “Geo – Group SH.P.K.&Ilyrian Consulting Engineers SH.P.K.” kundër Vendimit për dhënie lidhur me aktivitetin e prokurimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projekteve për ndërtim te ulet” me nr. të prokurimit: "616-23-4727-2-1-1" me 10/06/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e GOE “Geo – Group SH.P.K.&Ilyrian Consulting Engineers SH.P.K” me nr. 2024/241. lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projekteve për ndërtim te ulet” me nr. të prokurimit: "616-23-4727-2-1-1"

2. Aktiviteti i prokurimit të ri-vlerësohet sipas nenit 59 dhe 60 të LPP, në bazë të aprovimit të kërkesave tjera për rishqyrtim nga ana e AK.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Geo – Group SH.P.K.&Ilyrian Consulting Engineers SH.P.K”.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 15.05.2023 Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Hartimi i projekteve për ndërtim te ulet” me nr. të prokurimit: "616-23-4727-2-1-1". Ndërsa me datën 01.03.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontrate “Florije Jahaj”, 810545907, me çmim të poentuar prej 61.7 .

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës, shërbime dhe me vlerë të parashikuar të kontratës për 300,000.00 euro.

Me 05.03.2024 OE “Geo – Group SH.P.K.&Ilyrian Consulting Engineers SH.P.K” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 11.03.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 20.03.2024 OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Geo – Group SH.P.K.&Ilyrian Consulting Engineers SH.P.K” me nr. 241/24, lidhur me aktivitetin “Hartimi i projekteve për ndërtim të ulet” me nr. të prokurimit: "616-23-4727-2-1-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Geo – Group SH.P.K.&Ilyrian Consulting Engineers SH.P.K” janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi 1: AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së sepse ka bërë trajtim jo të barabartë të OE duke eliminuar grup-konsorciumin tone me arsyen se “Nuk plotesojme kushtet pasi OE-ik duhet të ofroj deshmi të mjaftueshme se ka realizuar shërbime të ngjashme në 3 vitet e fundit minimum 200.000.00 euro për projekte të Infrastruktura rrugore (min 51 % bartesi i konsorciumit)” kur grupi-konsorciumi i Operatoreve Ekonomik “Geo-Group” sh.p.k. & “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” sh.p.k., me përfaqësues, operator kontaktues i grup-konsorciumit shoqerine “GeO-Group” sh.p.k., dhe me Bartes/Lider shoqerine “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” sh.p.k., sic citohet në marrëveshjen e grup konsorciumit dorezuar në tender e ka plotësuar kushtin e ofrimit të deshmise se mjaftueshme të realizimit shërbime të ngjashme në 3 vitet e fundit me vlerë me të lartë se minimumi kërkuar 200 000 Euro, duke paraqitur edhe dokumentacionin e kërkuar për të deshmuar përmbushjen e kërkeses. AK ka shkelur dispozitat ligjore të LPP-se, duke eliminuar OE grup-konsorciumin tone me arsyen se “Grupi i Operatoreve Ekonomik “GeO-Group” sh.p.k. & “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” sh.p.k., nuk plotëson kërkesën: OE-ik duhet të ofroj deshmi të krenaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi bankar i OE-ik gjatë tri viteve të fundit ka qenë jo më pak se 300,000.00 euro (51 % Bartesi i konsorciumit) kur në një kohë grupi - konsorciumi i Operatoreve Ekonomik “GeO-Group” sh.p.k. & “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” sh.p.k., me përfaqësues, operator kontaktues i grup- konsorciumit shoqerine “GeO-Group” sh.p.k., dhe me Bartes/Lider shoqerine “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” sh.p.k., sic citohet në marrëveshjen e grup konsorciumit dorezuar në tender e ka plotësuar kërkesën sipas pike nenit 8.1 & 8.2, Kërkesa mbi gjendjen ekonomike dhe financiare kur qarkullimi bankar i Bartesit/Liderit është në vlerë prej 1 345 128 EURO. AK, në njoftimin me Letër standarde të datës 11.07.2023, ka shkelur dispozitat

ligjore te LPP-se per faktin se ka eliminuar OE grup-konsoriumin tone “Grupi i Operatoreve Ekonomik “GeO-Group” sh.p.k. & “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” sh.p.k. dhe ne kundërshtim me dosjen e tenderit dhe aktet ligjore ne fuqi dhe ka shpall fitus OE NSH 3 D Projekt i cili është i pa përgjegjshëm dhe i cili nuk plotëson kriteret e dosjes se tenderit. OE NSH 3 D Projekt, është i pa përgjegjshëm për faktin se i njëjti ka ndërhy ne Panamasë dhe parallogari, jashtëligjshëm dhe ne kundërshtim me dosjen e tenderit dhe dispozitat e LPP-se, sepse nuk mund te ofrohet çmim 0.000 e cilat si dëshmi mund ti shihni si me poshtë: Pra AK, ka vepruar ne kundërshtim me dosjen e tenderit dhe Paramasen dhe Parallogarin.

Pretendimi 2: AK ka shkelur nenin 56 “Dispozitat e Pergjithshme per Perzgjedhjen e Pjesemarrësve dhe Dhenien e Kontratave” qe parashikon se *“Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes: së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit tëspecifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji; ë dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kriterëve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji.”*. Grupi - Konsorciumi i Operatoreve Ekonomik “GeO-Group” sh.p.k. & “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” sh.p.k., me perfaqesues, operator kontaktues i grup- konsorciumit shoqerine “GeO-Group” sh.p.k., dhe me Bartes/Lider shoqerine “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” sh.p.k. ka permbushur te gjitha kerksat dhe kriteret e parashikuara ne FTD dhe ne Dosjen e Tenderit.

Pretendimi 3: AK me Formularin B58 - Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues te dates 11.07.2023 ka shpallur fituese duke e shperblyer me kontrate operatorin ekonomik “N.SH. 3D - PROJECT” me cmim oferte si ekonomikisht me te favorshme te poentuar prej 0.08 Euro. AK ka shkelur kuadrin ligjor prokurues ne fuqi me shperblimin e kontrates se operatorit ekonomik “N.SH. 3D - PROJECT” me cmim oferte si ekonomikisht me te favorshme te poentuar prej 0.08 Euro, pasi oferta e tij eshte me 0 pas presjes, pra 0.08 Euro qe nuk lejohet. Poashtu AK nuk ka respektuar dispozitat e nenit 72 te LPP-se, Dokumentacioni dhe informacioni shtesë ku Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji. Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 26.03.2024 ka autorizuar ekspertin, për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 241/2024, ndërsa me datë 04.04.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2024/241 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim. Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues Nuk është përgjigjur lidhur me rekomandimin e ekspertit, Ndërsa OE është Pajtuar lidhur me rekomandimin e ekspertit shqyrtues. Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.- Administrimi dhe vlerësimi i provave –Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale. Lidhur me pretendimet e OE “Geo – Group SH.P.K.&Ilyrian Consulting Engineers SH.P.K” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/241 ka vlerësuar si në vijim:

AK i Komunës së Prishtinës nuk e ka respektuar vendimin e OSHP-se me nr. 2023/0544 lidhur me pretendimin ankimor të kriterit të vlerësimit “OE duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues së qarkullimi bankar i OE, gjatë tri viteve të fundit ka qenë jo më pak se 300,000.00 euro- (51% Bartësi i konzorciumit)”. Pas vendimit të OSHP-së AK-ja Komuna e Prishtinës ka bërë rivlerësimin por prapë nuk i ka respektuar rekomandimin e bordit të OSHP-së që GOE - Group SH.P.K. & ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS SH.P.K.” ankues e ka plotësuar kriterin tekniko profesional pasi lideri i grupit e përmbushë vetëm me një referencë që ka dorëzuar, e përmbushë kushtin prej 51% që kjo tregon se ky AK është subjektivë edhe përkundër rekomandime të dhëna nga OSHP-ja por edhe dëshminë që ka prezantuar GOE - Group SH.P.K. & ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS SH.P.K.” që shihet qartë zyra e prokurimit dhe anëtarët e vlerësimit të ofertave i inkriminon dhe i bën përgjegjës ligjërisht për vlerësim subjektiv madje veprimi i tillë konsiderohet kundërligjor. **Deklarimet** tatimore për tri vite unë si ekspert i kam vërtetuar se qarkullimin për tri vite e ka 449,730,096 mil. Lek e nëse i konvertojmë në euro kap vlerën 4,385,767.90 € gjithashtu edhe referencat.

Pretendimi 1 dhe 2

Ne këtë rast që OE ankues ju ka referuar nenit 6 eksperti mendon se nuk ka të bëjë nënë 6 vetëm siguruar se fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efektive dhe ekonomike ose çmimi por edhe kushtet tjera të ligjit, nëse do të ishte në dosjen e tenderit që të ofertohej vetëm çmimi mendoj se AK nuk i ka respektuar nenin 6 mirëpo këtu janë kërkuar edhe kushtet tjera që në këtë rast unë si ekspert po konstatoj se GOE ankues i ka plotësuar kushtet që i parasheh qëllimi i nenit 6.

Autoriteti kontraktues nuk i ka trajtuar operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese sipas nenit 7, nuk ka vepruar në mënyrë transparente mundet të cilësohet se është bërë një diskriminim nga AK-ja, OE ankues e ka referencën që është kërkuar në pikën 9.1 & 9.2 të FTD me këtë referencë të dorëzuar nga lideri është pranuar edhe në vendimin paraprak të OSHP.

Pretndimi 3

GOE - Group SH.P.K. & ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS SH.P.K.” ankues kanë caktuar se lideri i grupit është kompania ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS SH.P.K në bazë të marrëveshjeve që kanë dorëzuar me oferte. Marrëveshjet që janë dorëzuar të GOE ankues janë në përputhje me ligjin të Prokurimit Publik të Kosovës pasi nuk është me rendësi se cili caktohet i pari (1) partner apo i dyti (2) me rendësi është me u cek cili është lideri në këtë rast është cekur lideri dhe të dy partneret kanë nënshkruar deklaratatë se i marrin përgjegjësit bashkërisht në këtë aktivitet të prokurimit ndërsa kush caktohet i pari apo i dyti është çështje teknike të çështja ligjore nuk interferon në proces të vlerësimit.

Gjithashtu askund në ligjin e prokurimit e as në Rregulloret në fuqi nuk ceket se personi kontaktues i grupit duhet të jetë nga lideri, se kush caktohet si person kontaktuesi i grupit kjo është çështje e brendshme e tyre (çështje teknike) e partnerëve në konzorcium në këtë aktivitet të prokurimit. Në bazë të dëshmive person kontaktues i caktuar Kushtrim Krasniqi nga partneri në konzorcium Geo Group shpk që për mendimin tim si ekspert konstatoj se e plotësojnë kriterin e dosjes së tenderit dhe pretendimi i OE ankues është i qëndrueshëm.

Personi I caktuar për përfaqësim të grupit – person kontaktues e ka autorizimin e nënshkruar nga dy palët që për ekspertin shqyrtues është plotësisht në përputhje me legjislacionin në fuqi arsyetimi I dhënë nga AK-ja Komuna e Prishtinës për eliminim është në kundërshtim me nenin 59 të LPP-se dhe në kundërshtim edhe me nenin 71 të LPP-se.

Gjithashtu në bazë të Rregullores 82/2022 nenin 26.3 AK –ja nëse ka paqartësi lidhur me grupin e OE ankues të e sqaroj. Shikoni nenin :

26.3 Një grup i OE nuk do të kërkohet të ketë formë të caktuar ligjore në mënyrë që të dorëzojë tenderin por AK rezervon të drejtën, nëse një kërkesë e tillë është e nevojshme për performancën e mirë të kontratës, të kërkojë nga grupi i përzgjedhur të ketë formë të tillë ligjore nëse kontrata i jepet një grupi të tillë si para-kusht të nënshkrimit të kontratës.

OE në Konzorcium kanë themeluar Grupin si lider është caktuar kompania e huaj jashtë R. Kosovës –kompania “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS SH.P.K” që për mua si ekspert është e logjikshme, ndërsa si person kontaktuese me AK me përfaqësuar grupin kanë caktuar një person z. Kushtrim Krasniqin nga kompania partnerë vendore ku e ka të lëshuar edhe autorizimin të nënshkruar nga dy partnerët.

Pretendimi 4

Sa i përket këtij pretendimi ankimor të gjitha kompanitë që kanë ofertuar nuk i kanë të plotësuar tabelën siç kërkohet me sistem, pra hapat që janë kërkuar në sistem nuk kanë plotësuar. Komisioni i vlerësimit Komunës së Prishtinës duhet vetë me i llogaritur poenta kështu që një arsyetimi i për eliminim të kompanisë ankues është selektive dhe e qëllimshme nga komisioni i vlerësimit dhe menaxheri i prokurimit pasi as kompania e rekomanduar nuk e ka plotësuar.

Shikoni tabelën e kompanish “Florije Jahaj” të rekomanduar nga AK-ja është e paplotësuar:

Në bazë të raportit të vlerësimit komisioni i ka bërë vlerësimin e ofertave sipas nën kritereve ku sipas nën kritereve del që ka kompani që është me poena më shumë se kompania e rekomanduar për kontratë kështu që vlerësimi i ofertave ka qenë subjektiv.

Kërkesat për rishqyrtim që janë bërë nga kompanitë tjera konkurrues si :

Studio Hapësira shpk,

Infra Plus shpk,

Vizion Projekti

Arhiko.Ing shpk në bazë të vendimit mbi kërkesat për rishqyrtim të datës 01.03.2024 të gjitha janë aprovuar pjesërisht të bazuar pretendimet e tyre ndaj kompanisë së rekomanduar për kontratë kështu që vetëm kompanisë Geo Grup shpk ju është refuzuar kërkesa për rishqyrtim .

Ne piken VI te vendimit ceket se anulohet njoftimi mbi vendimin i datës 01.03.2024 ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet ne Ri-vlerësim.

Gjithashtu unë si ekspert shqyrtues nuk i kam gjetur ne sistem e-prokurim vazhdimin e vlefshmërisë te kompanisë se rekomanduar për kontratë dhe kompanive qe kane ofertuar ne këtë aktivitet qe është kërkuar nga AK-ja me datën 26.02.2024 ku si pretendim ankimor ka qene ne kërkesën për rishqyrtim.

Ne baze te kësaj te cekur me larte konstatoj si ekspert se pretendimi është pjesërisht i bazuar se Komuna e Prishtinës duhet se pari ti beje vlerësimin real te ofertave për kriteret administrative dhe tekniko profesionale qe janë kërkuar ne dosjen e tenderit e tani te bej vlerësimin sipas nen kriterëve qe kane qene ne dosjen e tenderit. Kompanitë qe nuk i kalojnë kriteret administrativo dhe tekniko profesionale nuk kane nevojë te hynë ne tabelën e vlerësimit sipas nen kriterëve siç ka ndodhur ne këtë rast, ka kompani qe është eliminuar për çmime te ulëta ndërsa është ne garën e vlerësimit me poena. Gjithashtu eliminimi i kompanive për çmime te jo normalisht te ultë nuk është bere sipas rregullores për çmime jo normalisht i ulet.

Pretendimi 5

Sa i përket pretendimit ankimor lidhur me qarkullimi qe duhet ti paraqet lideri i grupit mbi 51 % bartësi i konzorciumit me kriteri i vlerësimit te DT:

Kërkesa :OE-ik duhet te ofroj dëshmi te kënaqeshe Autoritetit Kontraktues se qarkullimi bankar i OE-ik , gjate tri viteve te fundit ka qene jo me pak se 300,000.00 euro- ((51% Bartësi i konzorciumit).

Dëshmia: Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo ne vendin e themelimit apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur

Sipas këtij kriteri dhe sipas nenit 68 te LPP-se AK-ja ka mundur ti kërkoj – vërtetoj qarkullimet para datës se njoftimit, mirëpo ne baze te dëshmive qe i ka dorëzuar me ofertë Deklarimet tatimore për tri vite unë si ekspert i kam vërtetuar se qarkullimin për tri vite e ka 449,730,096 mil. Lek e nëse i konvertojmë ne euro kap vlerën 4,385,767.90 € del se lideri i grupit ka qarkullim shume me shume sa është kërkuar ne dosjen e tenderit .

Unë si ekspert mendoj se komisioni i vlerësimit i AK-se dhe menaxheri i prokurimit ka qene subjektiv ne vlerësim te ofertës se GOE ankues pasi ky pretendim sipas ekspertit shqyrtues është i bazuar.

Gjithashtu te ky pretendim është miratuar ne vendimin paraprakë nr. 2023/0544 mirëpo menaxheri i prokurimit nuk i ka marr për baze fare vendimin e OSHP-se kështu qe mendoj se ka

bere shkelje te LPP-se qe nuk i ka respektuar vendimin e OSHP-se.

Pretendimi 6

GOE - Group SH.P.K. & ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS SH.P.K.” ankues kane ngritur si pretendim ankimor se është shkëlur neni 72 pasi nuk kane kërkuar sqarime për paqartësi edhe pse te gjitha dokumentet kane qene te qarta ne oferte. Ne këtë rast veprimi arbitrare i AK-se sipas eksperti shqyrtues është i dëmshëm për kompanitë pasi konstatojnë se AK-ja ka mundur me vërtetuar disa paqartësi nëse ka pas. Eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor qëndron.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, dhe kjo seancë u mbajtë me dt. 06.06.2024.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projekteve për ndërtim te ulet” me nr. të prokurimit: "616-23-4727-2-1-1", ka dallime në arsyetimin e cituar tek letra standarde për tenderuesit e eliminuar e dt. 01.03.2024, me vendimin e AK për përgjigje në kërkesë për ri-shqyrtim të OE ankues të dt. 11.03.2024. Ngase, në letrën standarde njëra ndër arsytet e eliminimit të këtij OE ankues është se administrativisht është i papërgjegjshëm duke mos plotësuar pjesën 1 të Formularit të Tenderit pika 3 nënkriteret 1 dhe 2, ndërsa në përgjigje të kërkesës për ri-shqyrtim, AK përgjigjet se OE ankues në këtë rast nuk është administrativisht i përgjegjshëm sepse është në kundërshtim me nenin 26, paragrafin 26.1, pika c) të Rregullores 001/2022 për prokurim publik. Sipas AK, sipas kësaj dispozite OE i cili caktohet të jetë lider të autorizohet edhe për të vepruar në emër të grupit, ndërsa në rastin konkret me marrëveshjen për themelimin e Grupit të Ooperatorëve Ekonomik, njëri anëtar është caktuar (lider) bartës i grupit, ndërsa tjetëri përfaqësues që të veprojnë në emër të grupit. Po ashtu, AK deklaroi se në dokumentet e ofruara nga ankuesi: Marrëveshja mbi themelimin e GOE, Autorizimi dhe Deklaratat përcjellëse të kësaj marrëveshje për themelimin e grupit, nëse krahasohen mes tyre ato janë në kundërshtim me nenin e lartëcekur, ngase në deklaratën e OE “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS SH.P.K” thuhet se i njëjti e lëshon këtë deklaratë në cilësinë e liderit të grupit e në anën tjetër deklarata nga GOE - Group SH.P.K thuhet se i njëjti lëshon këtë deklaratë në emër të të partnerit të parë. AK, po ashtu, në këtë përgjigje deklaroi se me qenë se kushti administrativ nuk është përmbushur, oferta refuzohet me njëherë si e papërgjegjshme pa nevojë që të kërkohen sqarime shtesë. Lidhur me të gjitha këto përgjegje të AK, eksperti shqyrtues nuk i ka administruar të gjitha si provë në hartimin e raportit të tij të ekspertizës si tij. OE ankues lidhur me këtë e devijon pretendimin e tij ankimor duke u thirrur në një interpretim të KRPP se mundet edhe një anëtar i grupit të dorëzojë edhe ofertën në emër të grupit.

Për Panelin Shqyrtues edhe pse AK pak a shumë ka ndryshuar arsyeshmërin e eliminimit të këtij OE ankues, PSH megjithatë konsideron se OE nuk ka ofertuar konform kërkesave të DT,

konkretisht nenit 11.1, pika c: "*një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit*". Si dhe është në kundërshtim me nenin 26, paragrafin 26.1, pika c) të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik. Ngase marrëveshja për themelimin e Grupit të OE nuk është në përputhje me këtë pikë, sepse në njërin anë ka caktuar liderin e grupit "ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS SH.P.K", ndërsa, anëtari i Grupit "GOE - Group SH.P.K" prezantohet si përfaqësues, po ashtu edhe Deklaratat përcjellëse të kësaj marrëveshje për themelimin e grupit, nëse krahasohen mes tyre ato janë në kundërshtim me nenin e lartëcekur, ngase në deklaratën e OE "ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS SH.P.K" thuhet se i njëjti e lëshon këtë deklaratë në cilësinë e liderit të grupit e në anën tjetër deklarata nga GOE - Group SH.P.K thuhet se i njëjti lëshon këtë deklaratë në emër të të partnerit të parë. Andaj, Paneli Shqyrtues konsideron se Grupi i OE ankues është i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit dhe nuk ka nevoj që të lëshohet në atë se kush ka të drejtë të ofertoj deri sa OE ankues nuk është eliminuar për këtë pikë, PSH nuk do të lëshohet edhe në pretendimet tjera ankimore deri sa të njëjtat nuk janë relevante dhe përcaktuese për një vendimarrje meritore.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik "Geo – Group SH.P.K.&Ilyrian Consulting Engineers SH.P.K" te aprovohet si e pjesërisht e bazuar. Lënda të ri-vlerësohet konfom neneve 59 dhe 60 të LPP, jo për shkak të kësaj ankese por pasi që edhe ashtu vendimi për dhënie i AK është anuluar nga vet AK, në bazë të aprovimit të disa kërkesave tjera për ri-shqyrtim, me çrast edhe ashtu lëndën e ka kthyer në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimet të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - " Geo- Group " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: